
**Karta e-dytë e-përgjithëshme
e apostollit Pjetër.**

Krye 1.

1 Simeon Pjetri, shërbëtuar edhe apostoll i

- Jisu Krishtit, mb' ata që kanë marrë për pjesë besë të-çëmuarë sa *edhe* ne, me anë të drejtëris' së Perëndisë t' ënë edhe të Shpëtimtarit Jisu Krisht; Hir edhe paqtim ushumoftë mbë ju me anë të të-njohurit të Perëndisë edhe të Jisu Krishtit, Zotit t' ënë.
- 3 Sikundrë e-hieruarshimja fuqi' e ati na fali gjith' ato që *duhenë* për jetë e për besë të-mirë me anë të të-njohurit t' ati që na thërriti me lavdi e me mirësi; Me anë të të-cilavet na ufal në më të-mëdhatë e të-nderçime të-zotuara, që me anë të këtyreve të bëhi pjesëtarë të naturës' së Perëndisë, dyke larguarë prisjenë që është me anë të dëshërimit ndë botët; Edhe për gjithë këtë *punë*, dyke vënë çdo të-përojekurë, shtoni ndë besët t' uaj mirësinë, edhe ndë mirësit diturinë, Edhë ndë diturit të përmbajturit' e vetëhesë, edhe ndë të-përmbajturit të vetëhesë durimnë, edhe ndë durimt besën' e-mirë,
- 7 Edhe ndë besët të-mirë vëllazërinë, edhe ndë vëllazërit dashurinë. Sepse po të jenë këto ndër ju edhe të shtëhenë, nukë dot' u bënë juve përtaçer të-epapemshim mbë të-njohurit të Zotit t' ënë Jisu Krisht. Sepse ay, mbë të-cilinë nukë janë këto, është i-verbërë, dritë-shkurtërë, edhe harroj pastrimin' e fajevet të ti të-vjetërë. Përandaj, o vëllazër, kujdesuni më tepërë të siguronit të-thërriturit' e të-sgjedhuritë t' uaj; sepse dyke

- 11 bërë këto, nukë dotë fëjeni kurrë. Sepse kështu me të-plotë dot' u epetë juve të-hyrë të ndë mbretërit të-përjetëshme të Zotit e Shpëtimtarit t' ënë Jisu Krisht.
- 12 Përandaj nukë dotë përtonj t' u'a bje ndër mënt këto përherë, ndonëse i dini, e 13 jeni të-forcuarë ndë këtë të-vërtetë. Po *unë* mendonj, se është e-drejtë, gjersa jam ndë këtë tendë, t' u ngut juve dyke prurë ndër 14 mënt; Sepse e di, se për-së-çpejti dotë a heth tej tendën t' ime, sikundrë edhe Zoti 15 ynë Jisu Krisht m'a çfaq. Po dotë kujdesem, që ju, edhe pas vdekjesë s' ime, të muntni përherë t' i kujtoni ato.
- 16 Sepse u bëmë juve të dini fuqinë edhe të-ardhurit' e Zotit t' ënë Jisu Krisht, jo dyke vaturë pas përrallave të-ndrequra me mjesh-tëri, po *me të-treguarë*, se me sytë t' anë e 17 pamë madhërin' e ati. Sepse mori nder e lavdi prej Perëndisë, Atit, kur i erdhi atinjë i-këtitillë zë prej lavdis' së-lavduruarshime,
- 18 „Ky është Biri im i-dashurë, ndë të-cilët gjeta pëlqim.“ Edhe këtë zë e dëguamë se erdhi nga qielli, kur ishimë bashkë me atë ndë malt të-shënjtëruarë.
- 19 Edhe kemi më të-vërtetuarë fjalënë profi-tike, ndë të-cilët bëni mirë të shikoni si ndë një kandile që ndrit ndë *një* vënt të-errëtë, gjersa të sbardhëllonjë dita, edhe yll' i dritësë të lintnjë ndë zëmërat t' uaj; Dyke diturë

që përpara këtë, se asndonjë profiti e shkronjesë nukë bënetë prej kupëtimit të-veçantë
 21 *t'ati që profiteps*. Sepse kurrë nukë erdhi ndonjë profiti prej dashurimi njeriu, po dyke ushtyturë prej Frymës' së-Shënjtëruarë folnë njerëzit' e-shënjtëruarë të Perëndisë.

Krye 2.

- 1 Po kanë qënë edhe profitër të-rrem ndër llaust, sikundrë edhe ndër ju dotë ketë mësonjës të-rrem, të-cilëtë dotë futnjënë fshehurazi eresira humbjeje, dyke mohuarë edhe atë Zotëninë që i bleu ata, edhe dyke hequrë kështu mbë vetëhen' e tyre humbje të-çpejtë.
- 2 Edhe shumë *veta* dotë venë pas humbjevet' t' atyre, për të-cilëtë udh' e' së-vërtetësë
- 3 dotë shahetë. Edhe për lakmim dot' u tregëtonjënë me fjalë të-çpifura: dënimi i të-cilëvet që moti nukë mënon, edhe humbja e atyreve nukë fle.
- 4 Sepse Perëndia ndë mos kurseu ëngjëjtë që fëjyenë, po i hodhi ndë funtt të dheut të-lidhurë me hekura errësire, e i dha që të ruhenë për gjyq; Edhe *ndë* mos kurseu botën' e-moçime, po pruri përmytje mbi botën' e të-pabesëvet, Edhe ruajtj Noenë vet'
- 6 i-tettë, *këtë* lëçitës të drejtërisë; Edhe dënoj ndë humbje qytetet' e Sodhomavet e të Gomorrësë, edhe i bëri hi, edhe i vuri shëmbëllë t' atyreve që dotë rroninë të-pa-

- 7 besë; Edhe shpëtoj të-drejtinë Llot, që helmonej prej të-sjellavet të-ndyra të të-pabesëvet; (Sepse ky i-drejtë, dyke ndënjurë ndër mest t' atyreve, ditë me ditë mundonte shpirtin' e ti të-drejtë me te-par' e me të-9 dëgjuarë punërat' e atyre të-paudha; Di Zoti të shpëtonjë besëtarëtë nga ngasja, edhe të-shtrëmbëritë t' i ruanjë për ditën' e gjyqit që
- 10 të mundonënë; Edhe më tepërë ata që venë prapa mishit me dëshërim ndyrësire, edhe bënëjnë për asgjë pushtetnë; *janë* kuximtarë të-vrazhëtë, *edhe* nukë trëmbenë dyke sharë
- 11 pushtetetë; Tek ëngjëjtë që janë më të-mëdhenj ndë forcë e ndë fuqi nukë bjenë kundrë atyre gjyqim të-foluri keq përpara Zotit.
- 12 Po këta posi shtëzë prej nature pa mënt, që kanë lindurë që të zihenë (ndë lak), e të prishenë, flasënë keq për gjërëra që s' i dinë, edhe dotë prishenë ndë prishjet të tyre, dyke
- 13 marrë pagën' e shtrëmbëris' së tyre. E numëronjënë për shëfrim të-kënaqurit' e-përditshim; *janë* të-shgjërruarë e të-fëlliqurë; gëzonenë ndë kobimet të tyre, kur han' e pinë
- 14 bashkë me ju; Sytë i kanë plot me kurvëri, edhe që nukë pushonjënë nga faji; gënjenjënë shpirtëra të-paforcuarë, kanë zëmërë të-stërviturë ndë lakmime, *janë* djem mallëkimi:
- 15 Dyke lënë udhën' e-drejtë, ukobuanë, e vanë pas udhës' së Vallaamit, *birit* të Vosorit,
- 16 i-cili deshi pagën' e shtrëmbërisë; Po uqër-

- tua për panomin' e ti; sepse kafshë pa gojë,
dyke folurë me zë njerju, e ndaloj marrësin'
17 e profitit. Këta janë kronje pa ujë, re që
shtyhenë prej ere së-fortë, për të-cilëtë është
ruajtur' errësir' e-zezë për gjithë jetënë.
- 18 Sepse dyke folurë shumë të-mëdha *fjalë*
kotësire, kobonjënë me dëshërimet' e mishit
e më ndyrësiratë ata që me të-vërtetë shpë-
tuanë nga ata që e shkonjënë jetënë ndë
19 kobim; Dyke zotuar' atyreve liri, tek ata
vetë janë robër të prishësë; sepse prej ati
që të mundetë ndonjë, këti i bënë të edhe
20 rop. Sepse ata që shpëtuanë nga ndyrësit' e
botësë me anë të të-njohurit të Zotit edhe Shpë-
timtarit Jisu Krisht, ndë ungatërofshinë përsëri
mbë këto, edhe të mundenë, mb' ata të-pastaj-
21 me të ubënë inë të-këqia se të-paratë. Sepse më
mirë ishte për ata të mos e kishinë njohurë
udhën' e drejtërisë, se passi e njohë të
kthenenë nga porosi' e-shënjtëruarë që udha
22 mb' ata. Edhe gjau mb' ata ajo që *thotë*
parimia e-vërtetë. „Qëni ukthye mbë të-
vjellët të ti;“ edhe, Derri si ula ushkrye
ndë lucët.

Krye 3.

- 1 Po u shkruanj juve, o të-dashurë, tashti
këtë kartë të-dytë, me të-cilatë *kartëra* çonj
mëndjenë t'uaj të-kthjellët me të-përmëndu-
2 rë; Qe të kujtoni fjalëtë që ufolnë më për-

- para nga profitërit' e-shënjtëruarë, edhe po-
rosin' e ne apostojvet të Zotit edhe Shpë-
3 timtarit. Di-e-ni më përpara këtë, se ndë
ditt të-pastajme dotë vinjënë përqeshës, të-
cilëtë dot' ecënjënë pas dëshërimëvet të tyre,
4 E dotë, thonë, ky është të-zotuarët' e t'ar-
dhurit t'ati? sepse që mb' atë *ditë* që flejtnë
atëritë, të-gjitha mbetenë kështu qe kur se
5 unis kriesa. Sepse dyke dashurë nuk' e dinë
këtë, se me fjalën' e Perëndisë ubënë qiejtë
njëherë moti, si edhe dheu që është bërë
6 prej uji e me anë uji; Me anë të të-cilavet bota
e-atëhershime umbulua me ujë edhe humbi;
7 Edhe qiejt' e-sorm edhe dheu me anë të
gjithasaj fjale janë ruajturë si ndë thesore,
dyke uruajturë për zjarr mbë ditët të gjyqit
e të humbjes' së njerësvet të-pabesë.
- 8 Edhe një, këtë, mos e harroni, se për anë
Zotit një ditë është si një mijë vjet, edhe
9 një mijë vjet si një ditë. Zoti nukë mënon
të-zotuarët' e ti, sikundrë e numëronjënë për
të-mënuarë: po tregon zëmërë të-gjerë mbë
ne, sepse nukë do të humbasënë disa *veta*,
10 po të-gjithë të vinjënë ndë pendim. Edhe
dita e Zotit dotë vinjë posi vjedhës natënë;
ndë të-cilët qiejtë dotë shkonjënë me kris-
më, e stiqiatë dyke undezurë dotë tretënë,
edhe dheu edhe punëratë që janë nd' atë
dotë digjenë tej-për-tej.
- 11 Kur pra këto të-gjitha tretënë, të-çfarëtë

- duhetë të jeni juve ndë të-sjella të-shën-
12 tëruara e ndë besë të-mirë, Dyke pritur' e
dyke dëshëruarë fort të-ardhurit' e ditës' së
Perëndisë, ndë të-cilët qiejtë dyke udjegurë
ndë zjarr dotë tretenë, edhe stiqiatë dyke
13 undezurë dotë tretenë ? Edhe pas të-zotuarit
t' ati presëmë qiej të-rinj edhe dhe të-ri,
ndë të-cilët rri drejtëri.
- 14 Përandaj, o të-dashurë, dyke priturë këto,
kujdesuni të gjëndeni përpara ati ndë paq-
15 tim pa palavi e pa të-metë. Edhe zëmërenë
e-gjerë të Zotit t' ënë numëro-e-ni për shpë-
tim, sikundrë edhe vëllaj ynë i-dashurë Pa-
vel u shkroj juve pas diturisë që i udha
16 ati, Sikundrë edhe ndë gjithë kartërat të tia,
dvke folurë ndër ato për këto punëra ; ndër
mest të të-cilavet ka ca qës' kupëtonenë, të-
cilatë të-paditurit' e të-paqëndruarshimitë i
shtrëmbëronjënë, sikundrë edhe shkronjat' e-
tjera, për humbjen' e vetëhes' së tyre.
- 17 Ju pra, o të-dashurë, dyke diturë që për-
para këto, ruhi, që të mos hiqeni me kobi-
min' e të-panomëvet, e të bini poshtë nga
18 siguria juaj. Edhe shtohi ndë hirt e ndë të-
njohurit të Zotit t' ënë edhe Shpëtimtarit Jisu
Krisht. Mb' atë *qoftë* lavdia edhe tashti edhe
ndë ditët të jetës' së-përjetëshme. Amin.

